

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates - Mall

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: Blerje materiale hidraulike per ujesjellsin për vitin 2023

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):
44115210-4 materiale hidraulike

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.660.085 (Njemiljonn e gjashteqind e gjashtedhete mije e tetedhete e pese leke) Leke pa TVSH

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

I. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet te dorezoje:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojces ...;*
- b. Formulari permbledhes i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme bazohen ne nenet 76, 82 dhe 83 te LPP, nenit 26, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet te dorezoje:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % i vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Argumentimi: Referuar nenit 43, pika 2, paragrafi c), dhe pika 3, te VKM nr. 285 date 19.05.2021.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallërave të furnizuara, kopje origjinale ose të noterizuara, ku të dhënat të jenë qartësisht të lexueshme.
- b) Nëse përvoja e mëparshme është e realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, kopje origjinale ose të noterizuara, ku të dhënat të jenë qartësisht të lexueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar** Në rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë një letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit të vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij

2.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar në vendin tone ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar në vendin tone ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- *Numeri i punonjësve të siguruar në tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave të jete jo më të vogël se 25 punonjës mesatar vetëtuar sipas faqes elektronike, shoqëruar me bordero të dorëzuara në organet tatimore (formular deklarami)*

Te gjitha Certifikatat ose ekuivalentet e tyre duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 40, pika 5) germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.1 Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin mostrat e produkteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesën për prokurim.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë “emërtimin e artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, emrin e ofertuesit, vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatat ISO 9001, skedat teknike me qëllim përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për mallrat objekt prokurimi, sipas shtojcës 5 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 40, pika 6) germa a), b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë se disponojnë artikujt në përputhje me

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Gjate hartimit të specifikimeve teknike, Grupi i punës për hartimin e tyre, i është referuar parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të hartuara për artikujt që kërkohej të blihen, janë bazuar në kërkesat e certifikatave .

Nepërmjet kërkesave ndaj OE ofertues për të paraqitur certifikata ISO apo Certifikata/Deklarata Konformiteti CE etj të cilat aplikohen edhe në komunitetin evropian, bëhet e mundur që të sigurohen artikujt me parametra që i përshkruajnë standartet.